



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 shtator 2024
Nr. Ref.: RK 2536/24

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI276/23

Parashtrues

Erxhan Ajeti

Kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit për refuzim të kërkesës nr. KI169/22 të 29 shtatorit 2023 të Gjykatës Kushtetuese

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Erxhan Ajeti nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon “*rishqyrtim*” të Vendimit për refuzim të kërkesës KI169/22 të 29 shtatorit 2023 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e pretendimeve të tij të ngritura në kërkesën e mëparshme KI169/22, përkatësisht rishqyrtimin e Vendimit për refuzimin e kërkesës KI169/22 të 29 shtatorit 2023.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes e-mailit e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.
7. Më 20 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë shtesë lidhur me rastin.
8. Më 28 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI276/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzie Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 27 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin e kërkesës dhe të qartësojë kërkesën.
10. Më 17 janar 2023, Gjykata i dërgoi sërish shkresë parashtruesit të kërkesës dhe njoftoi për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 5 mars 2024, Gjykata përmes e-mailit zyrtar pranoi një përgjigje nga parashtruesi i kërkesës, por jo formularin e plotësuar.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç’ rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 11 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë për herë të dytë në Gjykatë. Nëpërmjet kërkesës së parë KI169/22, parashtruesi i kërkesës nuk kishte kontestuar ndonjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik dhe, nuk kishte qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i ishin cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik. Gjykata kërkesën KI169/22 e kishte refuzuar me procedurë të shkurtër, pasi kishte vlerësuar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak të mos kompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 25 (2) (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës.
15. Faktet e kërkesës së tanishme KI276/23, janë të reflektuara në detaje në rastin KI169/22 (shih rastin [KI169/22](#), parashtrues *Erxhan Ajeti*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 29 shtatorit 2023).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës kërkoi “rishqyrtim” të Vendimit për refuzim të kërkesës KI169/22, të 29 shtatorit 2023. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “... *teksti në vendim është konfuz ... andaj po ju dokumentoj me prova e edhe përmes kësaj kërkesë e provoj se problemi është në Gjykatën Themelore, prokuroria themelore, gjykata komerciale*”. Parashtruesi i kërkesës ka ripërsëritur pretendimet sikurse në rastin KI169/22.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës me anë të dokumenteve të paraqitura nuk paraqet ndonjë fakt të ri të rëndësishëm për marrjen e një vendimi të ri, por thjesht paraqet një përpjekje tjetër të parashtruesit të kërkesës për të kërkuar nga Gjykata të njëjtin vlerësim kushtetues të cilin ai tashmë e kishte kërkuar përmes kërkesës, në rastin KI169/22.
19. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 116. 1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”

20. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe rregullit 54 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

[...]

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

[...]

*(b) kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata; ose
[...]"*

21. Bazuar në rregullin e lartcekur dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), por edhe vetë praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit të deklarojë një kërkesë të papranueshme pas vlerësimit se kërkesa në fjalë është vetëm një përsëritje e kërkesës së njëjtë me rastin e mëparshëm.
22. Gjykata rikujton se kërkesa aktuale me nr. KI276/23, e paraqitur nga i njëjti parashtrues, është vetëm një përsëritje e kërkesës së njëjtë të mëparshme nr. KI169/22 të paraqitur nga po i njëjti parashtrues i kërkesës, të cilën Gjykata e shpalli të papranueshme në pajtim me rregullat 25 (2) (h) dhe 54 (2) (a) të Rregullores së punës.
23. Gjykata rikujton se ankimimi individual në kuptim të nenit 113. 7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtruesit e kërkesës si një mundësi për të kërkuar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata që të rihapë vendimet e saj dhe të gjykojë sërish çështjen e njëjtë (shih rastet e Gjykatës: rasti [KI105/16](#), parashtrues [Feti Gashi](#), Vendimi për refuzim të kërkesës, i 10 majit 2017, paragrafi 21).
24. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, të gjithë personat fizikë apo juridikë dhe institucionet në Republikën e Kosovës (shih rastet e Gjykatës, rastin [KI102/19](#), parashtrues [Bedri Gashi](#), Vendimi për refuzim të kërkesës, i 5 dhjetorit 2019, paragrafët 21 dhe 22, dhe gjithashtu, rastin KI96/23, parashtrues [Muhamet Miftari](#), Vendim për refuzim të kërkesës, i 18 shtatorit 2023, paragrafi 37).
25. Bazuar në elaborimin e mësipërm, Gjykata vjen në përfundimin se kërkesa e parashtruesit në fakt është kërkesë për përsëritjen e një procedure të mëhershme, për të cilën Gjykata tanimë ka vendosur. Prandaj, në përputhje me rregullin 54 (2) (b), Gjykata vendosi që kërkesa me numër KI276/23 të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 116. 1 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 54 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani